

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“MARVEL TECH” SH.P.K.



2024

TABELA E LENDES

DISPOZITA TE PERGJITHSHME.....	4
Forma ligjore dhe emri i shoqerise.....	4
Ortakët e shoqërisë.....	4
Kohëzgjatja.....	4
Selia.....	4
Objekti i aktivitetit	5
KAPITALI DHE KUOTAT	5
Kapitali themeltar	5
Regjistri i kuotave të kapitalit themeltar	5
Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnet të ortakut.....	5
Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi	6
Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar	6
Zmadhimi i kapitalit me anë të kontributeve në para.....	6
Zmadhimi i kapitalit me anë të kontributeve në natyrë.....	6
Zvogëlimi i kapitalit	7
ORGANET DREJTUESE DHE TËADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË.....	7
Organet drejtuese.....	7
Ortaku i vetëm, kompetencat	7
Administratori	7
Kompetencat e Administratorit	8
Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit.....	8
Procedura e emërimit dhe e shkarkimit të Administratorit	9
Personeli i shoqërisë.....	9
MBLEDHJET DHE VENDIMMARRJA NË SHOQËRI	9



Aktet e ortakut të vetëm	9
VITI FINANCIAR, RAPORTET VJETORE, FITIMI.....	9
Viti financiar	9
Raportet vjetore	10
Eksperti kontabël.....	10
Përgjegjësitë e Ekspertit kontabël	10
Të drejtat dhe detyrimet e ekspertit kontabël	10
Shkarkimi i ekspertit kontabël.....	11
Fitimi i shoqërisë.....	11
PRISHJA, SHNDËRRIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.....	11
Prishja e shoqërisë.....	11
Shndërrimi i shoqërisë.....	12
Likuidimi i shoqërisë.....	12
DISPOZITA TË FUNDIT.....	12
Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve.....	12
Ndryshimet në Statut.....	12



Kreu I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore dhe emri i shoqerise

- 1.1. Emri i shoqerisë do të jetë **“MARVEL TECH”** sh.p.k.
- 1.2. **“MARVEL TECH”** sh.p.k. është themeluar bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* i ndryshuar.
- 1.3. **“MARVEL TECH”** sh.p.k. është themeluar dhe funksionon si shoqëri tregtare e formës *“me përgjegjësi të kufizuar”* (sh.p.k.). Nga këtu e më poshtë në këtë statut shoqëria **“MARVEL TECH”** sh.p.k. do të referohet si **“Shoqëria”**.
- 1.4. Shoqëria fiton personalitetin juridik si dhe të drejtën për të kryer veprime dhe të marrë përsipër të drejta dhe detyrime gjatë aktivitetit të saj të përditshëm, që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.5. Shoqëria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit të përcaktuar në këtë statut, bazuar në legjislacionin Shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Ortakët e shoqërisë

- 2.1. Shoqëria është themeluar nga një Ortak i vetëm **Z. Elger Tota**, shtetas shqiptar me Nr. Personal ID J40615083C, lindur ne Tirane, me 15 qershor 1994, me adrese Rr. "Koço Bozhori", Ndërtesa 126, Njësia Administrative Nr.2, Tiranë (në vijim **“Ortaku i Vetëm”**).
- 2.2. Ortaku i Vetëm përgjigjet për humbjet e Shoqërisë deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
- 3.2 Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

Neni 4

Selia

- 4.1 Shoqëria ka selinë e saj në **“Rruga Petro Nini Luarasi, Pallati Omras 2000, kati i 1-rë, Njësia Administrative Nr.2, Tiranë.**
- 4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.
- 4.3 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Ortakut të Vetëm.



Neni 5

Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë kryerje e veprimtarisë së shitje/blerjeve me pakicë dhe shumicë të produkteve elektronike. Ofrimi i shërbimit të konsulencës dhe marketingut për produktet elektronike dhe çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas legjislacionit në fuqi, shoqëria në mënyrë që të arrije objektivat e saj mund të kryejë aktivitete të konsideruara të dobishme apo te nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë. Për më tepër Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër, i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi, që sjell përfitime dhe është në interes të Shoqërisë.

Kreu II

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare "MARVEL TECH" sh.p.k. është 100 Lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar është i ndarë në një kuotë.
- 6.3 Ortaku i Vetëm është zotëruesi i të gjitha kuotes/ave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre.
- 6.4 Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.
- 6.5 Çdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.

Neni 7

Regjistri i kuotave të kapitalit themeltar

- 7.1 Kuotat dhe zotëruesi i tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen në një regjistër të posaçëm.
- 7.2 Forma dhe modalitetet e tjera të regjistrit miratohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 7.3 Në rast të zotërimit të kuotave të shoqërisë nga më shumë se një ortak forma dhe modalitetet e tjera të këtij regjistri miratohen me vendim të ortakëve që zotërojnë më shumë se 3/4 e kuotave.

Neni 8

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnet të ortakut

- 8.1 Ortaku i Vetëm mundet të transferojë lirisht tek të tretët, pjesërisht ose tërësisht, pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 8.2 Në rast se në një moment të caktuar pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë zotërohen nga më shumë se një ortak, transferimi i këtyre pjesëve brenda shoqërisë mund të bëhet lirisht, ndërsa transferimi tek personat e tretë mund të bëhet vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.



Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, nëpërmjet trashëgimisë, si dhe midis bashkëshortëve në rast ndarje pasurore.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, midis bashkëshortëve si dhe midis prindit dhe fëmijës ose anasjalltas.

Neni 10

Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar

- 10.1 Në çdo rast transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnetin e Ortakut të Vetëm duhet të vërtetohet nëpërmjet një akti noterial.
- 10.2 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar pasqyrohen në regjistrin e posaçëm të miratuar sipas nenit 7 të këtij Statuti. Mospasqyrimi i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në këtë regjistër, nuk e bën të pavlefshëm aktin e transferimit.
- 10.3 Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit jo më vonë se një muaj nga data e regjistrimit të këtij akti në zyrën noteriale përkatëse.
- 10.4 Kërkesa për depozitim të aktit të shitjes së pjesëve të kapitalit themeltar mund të bëhet nga shitësi ose nga blerësi, ose prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Neni 11

Zmadhimi i kapitalit me anë të kontributeve në para

- 11.1 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet me kontribute në para me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 11.2 Zmadhimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet me shlyerjen tërësisht të vlerës së shtuar prej Ortakut të Vetëm.
- 11.3 Shlyerja e fondeve mund të vërtetohet nga një zyrë noteriale ose nëpërmjet një dokumenti bankar.
- 11.4 Në rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozitimit të fondeve, Ortakut të Vetëm i lind e drejta të tërheqë fondet e depozituara.

Neni 12

Zmadhimi i kapitalit me anë të kontributeve në natyrë

- 12.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në natyrë bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 12.2 Të dhënat mbi kontributin në natyrë të shtuar si pjesë e kapitalit themeltar pasqyrohen në Statut dhe regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në rast të kundërt zmadhimi konsiderohet i përealizuar.



Neni 13

Zvogëlimi i kapitalit

- 13.1Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm duke respektuar në çdo rast minimumin ligjor të kapitalit themeltar.
- 13.2Vendimi përkatës pasqyrohet në Statut si dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përndryshe është i pavlefshëm.
- 13.3Nëse e çmon Ortaku i Vetëm mundet të caktojë një ekspert kontabël për të verifikuar procedurat dhe aktin e vlerësimit.

Kreu III

ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

Neni 14

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a. Ortaku i Vetëm;
- b. Administratori.

Neni 15

Ortaku i vetëm, kompetencat

- 10.1Ortaku i Vetëm ka këto kompetenca:
- a. Ndryshimet në dispozitat e Statutit;
 - b. Caktimi dhe shkarkimi i administratorit/es;
 - c. Caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/ekspertëve kontabël si dhe likuidatorit/likuidatorëve;
 - d. Miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit;
 - e. Miratimi i raportit vjetor;
 - f. Shpërndarja e dividendëve;
 - g. Ndryshimi i kapitalit themeltar;
 - h. Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar tek palët e treta;
 - i. Likuidimi dhe/ose shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër;
- 10.2Ortaku i Vetëm, veç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat në lidhje me administrimin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që ky Statut ia njej dhe ia ngarkon Administratorit/es.

Neni 16

Administratori

- 16.1Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 16.2Në aktin e emërimit përcaktohet edhe periudha e qëndrimit në detyrë. Në rast se kjo periudhë nuk është përcaktuar në aktin e emërimit ajo në çdo rast nuk mundet të jetë më shumë se pesë vjet, duke filluar ky afat nga data e emërimit.



16.3 Administrator i shoqërisë emerohet **Z. Elger Tota**, shtetas shqiptar me Nr. Personal ID J40615083C, lindur ne Tirane, me 15 qershor 1969, me adrese Rr. "Koço Bozhori", Ndërtesa 126, Njësia Administrative Nr.2, të cilat emërohen në këtë detyrë për një periudhë 1 (një vjeçare), me te drejtë ripërtëritje.

Te dhenat e Administratorit/es	Specimen i nenshkrimit
Elger Tota Shtetas shqiptar Lindur me: 15.06.1994 Nr. Kartes se identitetit: J40615083C	

Neni 17

Kompetencat e Administratorit

Administratori i Shoqërisë ka këto kompetenca:

- a. Përfaqëson interesat e Shoqërisë në raport me të tretët;
- b. Përgjigjet për administrimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë;
- c. Nënshkruan marrëveshje në emër dhe për llogari të Shoqërisë sipas përcaktimeve në këtë Statut;
- d. Përgatin raportin vjetor të administrimit të Shoqërisë, inventarët dhe llogaritë vjetore;
- e. Emëron dhe shkarkon personelin e Shoqërisë;
- f. Gjithçka tjetër në lidhje me administrimin e Shoqërisë të cilat nuk janë përcaktuar nga ligji si kompetencë e Ortakut të Vetëm;

Neni 18

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

- 18.1 Administratori/ja ka të drejtë e detyrohet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Ortaku i Vetëm;
- 18.2 Të përfaqësojë Shoqërinë;
- 18.3 Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- 18.4 Të përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'ja paraqesin këto dokumente Ortakut të Vetëm për miratim;
- 18.5 Të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- 18.6 Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 18.7 Të raportojë përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;

18.8 Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

Neni 19

Procedura e emërimit dhe e shkarkimit të Administratorit

- 19.1 Akti i emërimit dhe shkarkimit të Administratorit duhet të jetë me shkrim.
- 19.2 Me emërimin e Administratorit, midis tij dhe Ortakut të Vetëm nënshkruhet një kontratë punësimi, në të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.
- 19.3 Administratori mund të shkarkohet në rast se ai nuk përmbush detyrimet që rrjedhin për të nga ky Statut, kontrata e punës, si dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor që lidhet me funksionin e tij.
- 19.4 Administratori mund të shkarkohet edhe kur humbet besimin e Ortakut të Vetëm.
- 19.5 Akti i shkarkimit të Administratorit duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përmbajë edhe shkaqet e shkarkimit.
- 19.6 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit mbarojn menjëherë me aktin e shkarkimit.

Neni 20

Personeli i shoqërisë

- 20.1 Personeli punonjës i Shoqërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim të Administratorit/es në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Punës, Statutin e shoqërisë si dhe akte të tjera të Ortakut të Vetëm.
- 20.2 Numri i punonjësve si dhe struktura organike si dhe niveli i pagave përcaktohen nga Administratori.

Kreu IV

MBLEDHJET DHE VENDIMMARRJA NË SHOQËRI

Neni 21

Aktet e Ortakut të Vetëm

- 21.1 Ortaku i Vetëm administron Shoqërinë nëpërmjet akteve të ndryshme të miratuara prej tij.
- 21.2 Aktet duhet të jenë me shkrim si dhe të regjistrohen në një regjistër të posaçëm.
- 21.3 Në rastet e shqyrtimit të raporteve të Administratorit/es, të inventarit si dhe të miratimit të llogarive vjetore, Ortaku i Vetëm njofton Administratorin/en dhe / ose likuidatorin, sipas rastit, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së shqyrtimit.

Kreu V

VITI FINANCIAR, RAPORTET VJETORE, FITIMI

Neni 22

Viti financiar

- 22.1 Llogaritja e shpenzimeve, të ardhurave dhe fitimit për Shoqërinë bëhet për çdo vit financiar.



22.2Çdo vit financiar fillon më datën 01 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 23

Raportet vjetore

- 23.1Administratori/ja apo sipas rastit eksperti kontabël paraqet raportet vjetore financiare jo më vonë se dymujori i parë i vitit financiar pasardhës.
- 23.2Raporti përmban të dhëna mbi shpenzimet, të ardhurat si dhe çdo informacion tjetër financiar mbi Shoqërinë.
- 23.3Ortaku i Vetëm miraton raportet financiare dhe llogaritë vjetore të vitit financiar jo më vonë se 6 mujori i parë i vitit financiar pasardhës.

Neni 24

Eksperti kontabël

- 24.1Emërimi i ekspertit kontabël bëhet nëpërmjet një akti me shkrim i cili i komunikohet personit të caktuar si ekspert kontabël i autorizuar.
- 24.2Eksperti kontabël emërohet për një periudhë prej 2 vitesh financiare duke përfshirë në këtë periudhë edhe vitin financiar në të cilin bëhet emërimi.

Neni 25

Përgjegjësitë e Ekspertit kontabël

- 25.1Eksperti kontabël kontrollon dhe verifikon të gjithë librat e llogarisë, fondet e Shoqërisë, kontratat, dokumentet kontabël, regjistra dhe procesverbale të financës.
- 25.2Eksperti kontabël kontrollon dhe verifikon nëse llogaritë vjetore dhe bilancet janë në përputhje me dokumentacionin financiar përkatës të Shoqërisë dhe janë pasqyruar të gjitha operacionet financiare të vitit.
- 25.3Eksperti kontabël kontrollon përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë e kontabilitetit të mbajtur me legjislacionin në fuqi.
- 25.4Eksperti kontabël i autorizuar është i përgjashtuar nga çdo ndërhyrje në administrimin e Shoqërisë.
- 25.5Në ushtrimin e përgjegjësisë së veta Eksperti kontabël mund të bëjë verifikime dhe kontrole në çdo kohë që ai e gjykon të nevojshme.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrimet e ekspertit kontabël

- 26.1Eksperti kontabël dhe / ose bashkëpunëtorët e tyre janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional, faktet, aktet dhe informacionet që kanë të bëjnë me shoqërinë dhe për të cilat kanë mundur të vihen në dijeni për shkak të funksionit.
- 26.2Eksperti kontabël ka të drejtën e pagesës me honorare në përputhje me akt-marrëveshjen me Ortakun e Vetëm ose me aktin e caktimit të tij si ekspert.



- 26.3Eksperti kontabël është i detyruar të vërë në dijeni menjëherë Ortakun e Vetëm për pasaktësi apo parregullsi të konstatuara nga ai gjatë verifikimit të dokumentacionit financiar të shoqërisë apo dhe verifikime të tjera të bëra në përputhje me detyrën e tij dhe që lidhen me mirëadministrimin ekonomik dhe financiar të shoqërisë.
- 26.4Eksperti kontabël është përgjegjës si ndaj Shoqërisë ashtu edhe ndaj të tretëve për dëmet që mund ti shkaktohen atyre për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të kryera me faj të ekspertit, si dhe për shkak të nënvleftësimit të treguar në veprimtarinë e tij.
- 26.5Eksperti kontabël përgjigjet për aq sa i takon edhe për veprime të kundraligjshme të kryera nga Administratori/ët, kur ai ka patur dijeni për to.
- 26.6Eksperti kontabël është i detyruar të respektojë krahas akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me ushtrimin e detyrës së tij si ekspert, edhe dispozitat e këtij Statuti si dhe çdo akt tjetër të miratuar nga Ortaku i Vetëm.

Neni 27

Shkarkimi i ekspertit kontabël

- 27.1Eksperti kontabël shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 27.2Akti i shkarkimit duhet të bëhet me shkrim.
- 27.3Eksperti kontabël i shkarkuar ka të drejtën e pagesës vetëm për punën e kryer dhe të papaguar.

Neni 28

Fitimi i shoqërisë

- 28.1Fitimi llogaritet në fund të çdo viti financiar.
- 28.2Shpërndarja e fitimit bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm pasi është lënë më pare mënjanë “rezerva e detyrueshme”.
- 28.3Ortaku i Vetëm mund të disponojë lirisht fitimin e shoqërisë, pasi të jetë lënë më pare mënjanë “rezerva e detyrueshme” dhe të jenë shlyer të gjitha detyrimet që shoqëria ka kundrejt shtetit.

Kreu VI

PRISHJA, SHNDËRRIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 29

Prishja e shoqërisë

- 29.1Shoqëria mund të prishet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 29.2Vendimi për prishjen e shoqërisë duhet të jetë me shkrim dhe duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 29.3Në rast se kapitalet e shoqërisë, vlerësuar sipas dokumenteve financiare përkatëse, janë në një vlerë më të vogël se gjysma e kapitalit themeltar, shoqëria konsiderohet e prishur.

Neni 30



Shndërrimi i shoqërisë

30.1 Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore sipas ligjit në fuqi.

30.2 Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 31

Likuidimi i shoqërisë

31.1 Në rastin e falimentimit të shoqërisë, ajo kalon në proces likuidimi.

31.2 Shoqëria është në proces falimentimi kur ajo është në pamundësi të pagesave ndaj të tretëve.

31.3 Në procesin e likuidimit, Ortaku i Vetëm ose gjykata cakton një likuidator, ekspert kontabël, për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërisë.

31.4 Projekti i likuidimit i paraqitur nga eksperti kontabël miratohet nga Ortaku i Vetëm ose nga gjykata.

31.5 Në procesin e likuidimit Shoqëria përfaqësohet nga likuidatori i cili është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët në përputhje me radhën e përcaktuar në legjislacionin shqiptar.

31.6 Pas përfundimit të procesit të pagimit të kreditorëve, vlera financiare dhe kapitale të tjera të shoqërisë, nëse ka, i dorëzohen Ortakut të Vetëm.

31.7 Aktet e likuidimit në përfundim të tij së bashku me llogaritë përkatëse depozitohen në Qendrën Kombëtare të regjistrimit. Pas kësaj Shoqëria çregjistrohet nga ky regjistër.

Kreu VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32

Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve

Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 33

Ndryshimet në Statut

33.1 Ndryshimet në Statut mund të bëhen me vendim të Ortakut të Vetëm.

33.2 Ndryshimet janë të vlefshmeve të nëse ato pasqyrohen në Regjistrin Tregtar.

33.3 Në rast të transferimit tërësisht ose pjesërisht të kuotave tek më shumë se një ortak, ky statut është i vlefshëm deri në bërjen e ndryshimeve përkatëse nga Ortaku i Vetëm sipas procedurave të parashikuara në ligj.



Deri atëherë zbatohen dispozitat e këtij Statuti përsa është e mundur dhe/ose dispozitat e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Ky Statut është i hartuar në katër kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij pranë Regjistrisë Tregtare.

Ortaku i Vetëm

Z. Elger Tota

ELGER TOTA
